



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Botimi 7

BULETINI

I

UDHËZIMEVE TEKNIKE NR. 7

(Korrik – Dhjetor 2020)



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

TABELA PËRMBLEDHËSE

1. **HYRJE**.....

2. **UDHËZIME TEKNIKE**.....

2.1. Sqaruese lidhur me procedurën e marrjes së autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nga furnizuesit e mallrave ose shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar dhe nënkontaktorët e tyre.

2.2. Rregullore mbi zbatimin e detyrimeve ligjore për raste të veçanta faturimi në kuadër të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshur.

2.3. Fatura e lëshuar nga personat rezidentë për marrjen e shërbimit nga personat jo rezidentë.

2.4. Lidhur me bonuset që përfitojnë punonjësit në varësi të natyrës së punës (volum shitje gjatë muajit).

2.5. Lidhur me Ligjin nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” si dhe udhëzimin nr.2727, datë 04.02.2020 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit”.

2.6. Sqaruese për qiratë financiare.

2.7. Sqaruese për menaxhimin e fondeve të investime kolektive.

2.8. Sqaruese lidhur me furnizimin e shërbimeve të kurseve private.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

I. HYRJE

Marrëdhëniet ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve rregullohen nëpërmjet dispozitave të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tyre. Këto dispozita saktësojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të tij tregtar. Vlen të theksohet se, prioritet i administratës tatimore është trajtimi i njëjtë dhe në mënyrë të barabartë i të gjithë tatimpaguesve si dhe respektimi korrekt dhe i njëjtë i dispozitave ligjore nga ana e tyre.

Në zbatim të Nenit 10, pika 3 e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në funksion të marrëdhënies së vazhdueshme administratë tatimore – tatimpagues, si dhe e udhëhequr nga parimet e administrimit tatimor të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, publikon Buletinin Nr.4, në të cilin janë përfshirë sqaruese/orientuese dhe trajtime për raste specifike të adresuara në administratën tatimore nga tatimpagues të ndryshëm që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Ky Buletin vjen si vazhdimësi e Buletineve të mëparshëm të publikuara në website-in e administratës tatimore, në të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në zbatim të detyrave të saj funksionale dhe në trajtim të dhjetëra shkresave dhe kërkesave të tatimpaguesve apo edhe të strukturave të saj të varësisë, ka përmbledhur raste specifike, të cilat mund të shërbejnë si referencë për tatimpagues të ndryshëm në trajtimin e një sërë problemesh që kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit tatimor, me procedurat tatimore apo edhe me çështje dhe raste praktike.

Referuar sa më sipër, ky Buletin, është një përmbledhje e sqarimeve, opinioneve dhe udhëzimeve, që kanë unifikuar qasjen e administratës tatimore kundrejt tatimpaguesve dhe përfshin periudhën nga 1 Janar 2019 deri më 30 Qershor 2019.

Ky Buletin në logjikën e buletineve të mëparshëm është i organizuar në 3 kapituj, të cilët respektivisht janë ndarë në kapitullin hyrës, në kapitullin II, në të cilin përfshihet një sqaruese/orientuese që u drejtohet Drejtorive Rajonale, me qëllim sqarimin e procedurave në lidhje me regjistrimin apo çregjistrimin nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së për OJF-të dhe unifikimin e veprimeve dhe qëndrimeve për trajtimin e këtyre të fundit. Si dhe një sqaruese në nëndarjen e dytë për Drejtoritë Rajonale Tatimore me qëllim verifikimin, vlerësimin dhe llogaritjen e tatimit në burim për ambjentet e dhëna me qira për qëllim të ushtrimit të një aktiviteti tregtar edhe kapitulli III, i cili përban një trajtim nga pikëpamja fiskale e huapërdorjes për sendet e luajtshme.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

2. UDHËZIME TEKNIKE

2.1. Sqaruese lidhur me procedurën e marrjes së autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm i Tatimeve nga furnizuesit e mallrave ose shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar dhe nënkontaktorët e tyre

VKM Nr. 143 datë 13.02.2020 “Procedurat për lëshimin e autorizimit për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve për qëllime të procesit të rindërtimit”, ka përcaktuar saktësisht subjektet dhe procedurën që do të ndiqet për dhënien e autorizimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, për të gjithë përfituesit nga përjashtimi i TVSH-së, subjekte të rindërtimit.

Duke qenë se VKM Nr. 143 datë 13.02.2020 ka pësuar disa ndryshime, për të kryer një administrim sa më transparent dhe të saktë lidhur me transaksionet që do të kryhen midis palëve (furnizues, kontraktorë, nënkontraktorë) subjekte të rindërtimit, duhet që të pajisen me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për të përfituar nga përjashtimi i TVSH-së të gjithë subjektet e rindërtimit, përfshi edhe subjektet që do të kryejnë furnizime direkt për ndërtuesit /kontraktorët kryesor si dhe subjektet nënkontraktorë të ndërtuesit/kontraktorit kryesor.

Për t’u pajisur me autorizim, subjektet furnizuese dhe nënkontaktorët duhet të bëjnë aplikim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku si pjesë të kërkesës duhet të paraqesin edhe dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit duhet të shoqërohet me kontratën e lidhur midis furnizuesit dhe ndërtuesit/kontraktor kryesor, nënkontaktorit dhe ndërtuesit /kontraktor kryesor. Në kontratë duhet të jetë përcaktuar qartë mallrat dhe shërbimet që do të ofrojë furnizuesi dhe nënkontaktori për ndërtuesin /kontraktor kryesor.
2. Preventivin e mallrave dhe punimeve që do të kryejë shoqëria furnizuese, dhe shoqëria nënkontraktore për ndërtuesin kryesor. Preventivi duhet të jetë ndarë në zëra, në sasi dhe në vlerë.

Një kopje e dokumentacionit të depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duhet të dorzohet pranë DRT-së që ka në administrim ndërtuesit kryesor, furnizuesit dhe nënkontaktorët.

Furnizuesit apo nënkontraktorët, bazuar në VKM Nr. 143 datë 13.02.2020, me marrjen e autorizimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, aplikojnë përjashtimin nga TVSH-ja, për furnizimet e kryera për ndërtuesit subjekte të rindërtimit. Asnjë përjashtim nuk akordohet për



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve që nuk furnizojnë direkt ndërtuesit subjekte të rindërtimit të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Përrjashtimi nga TVSH-ja duhet të reflektohet në çmimin e shitjes së këtyre mallrave dhe shërbimeve, furnizime të cilat duhet të jenë dukshëm me çmime me të ulëta se furnizimet e ngjashme për raste të tjera jo për qëllime të fatkeqësisë natyrore. Verifikimi i çmimeve të aplikuara do të jetë objekt verifikimi nga strukturat funksionale të administratës tatimore.

Shoqëritë furnizuese që do të furnizojnë subjektet e rindërtimit të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, nuk gëzojnë të drejtën e zbritjes e TVSH-së mbi këto mallra dhe shërbime.

Të gjitha faturat e lëshuara nga furnizuesit për subjektet e rindërtimit të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, duhet të shoqërohen me referencën ligjore, sipas së cilës furnizimi është i përjashtuar, numrin, datën e autorizimit të përjashtimit si edhe fotokopjen e autorizimit.

Subjektet ndërtuese të përfshira në procesin e rindërtimit apo furnizuesit kryesorë të tyre, mund të zgjedhin të aplikojnë ose jo për tu pajisur me autorizim për përjashtim nga TVSH-ja. Nëse furnizuesit/nëkontraktorët zgjedhin të mos bëjnë kërkesë për tu pajisur me autorizim për përjashtim nga TVSH-ja, ose kanë kryer furnizime mallrash ose shërbimesh për periudhën që nuk janë pajisur me autorizim, nuk e gëzojnë të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi këto furnizime. Në këto raste, shoqëritë furnizuese për mallrat dhe shërbimet e ofruara, do të kryejnë rregullimin e TVSH-së së zbritshme, për të gjitha furnizimet e ofruara shoqërive ndërtuese të autorizuar.

Autorizimi i lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve nuk ka fuqi prapavepruese dhe nuk i shtrin efektet mbi furnizimet e kryera para pajisjes me autorizim të subjektit përfitues, por skema e përjashtimit të TVSH-së zbatohet vetëm për furnizimet pasuese. Për të gjitha furnizimet e kryera para pajisjes me autorizim, të zbatueshme janë parashikimet si më sipër. Furnizuesit e mallrave/shërbimeve të përjashtuara nga TVSH-ja për procesin e ndërtimit, në momentin e lëshimit të faturës tatimore duhet të shënojnë në faturë dispozitën ligjore, sipas së cilës furnizimi është i përjashtuar, si dhe numrin e datën e autorizimit të përjashtimit.

TVSH-ja në blerje për mallrat dhe shërbimet që janë furnizuar shoqërive të autorizuar për procesin e rindërtimit, do të kontabilizohet në llogarinë e shpenzimeve dhe do të njihet si shpenzim i zbritshëm për efekt fiskal.

Të gjitha transaksionet e kryera midis palëve në bazë të kontratave, do të kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nuk e përfitojnë këtë përjashtim, furnizimet e mallrave dhe të shërbimeve që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndërtimin brenda programit të rindërtimit

2.2. Rregullore mbi zbatimin e detyrimeve ligjore për raste të veçanta faturimi në kuadër të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar.

1. Elementët e nevojshëm për fiskalizimin

Referuar nenit 18, të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar (më tej “Ligji”), elementët standard të nevojshëm për të kryer lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, janë:

- Pajisje elektronike (kompjuter, laptop, telefon, tablet, etj);
- Printer;
- Zgjidhje software e certifikuar dhe mirëmbajtës për zgjidhjen software;
- Lidhje e pandërprerë me internet;
- Certifikatë elektronike.

Elementët e mësipërm janë të domosdoshëm në çdo rast kur tatimpaguesi lëshon dhe fiskalizon fatura nëpërmjet një zgjidhjeje software të certifikuar.

Prodhuesit dhe mirëmbajtësit e certifikuar për zgjidhjet software listohen në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Certifikata elektronike merret online pranë AKSHI-t nëpërmjet aplikimit në portalin e-Albania.

Fatura e lëshuar për të dokumentuar transaksionet me para në dorë është dokument i mjaftueshëm tatimor për qëllim të njohjes së shpenzimeve fiskale. Pra nuk është e nevojshme që të bashkëshoqërohet me dokument tjetër.

Të dhënat dhe elementët që duhet të përmbajë fatura përshkruhen në nenin 9 dhe 11 të ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit. Faturat e marra si dhe ato të lëshuara, regjistrohen në mënyrë automatike në librin e blerjes dhe shitjes. Në libër mund të kryhen veprime saktësuese për regjistrimin e faturave, pa ndryshuar elementët përbërës të faturës. Në këtë mënyrë procedohet edhe me dorëzimin e deklaratës së TVSH-së nëse tatimpaguesi ka detyrimin për dorëzimin e saj.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Përpara fillimit të procedurave të fiskalizimit, tatimpaguesi duhet që të japë informacionin e kërkuar, nëpërmjet Portalit SelfCare. Informacioni duhet të jepet mbi njësinë në të cilën kryhet aktiviteti, pajisjes/eve elektronike që përdor, zgjidhjes software e mirëmbajtësit të saj si dhe informacion për personin e autorizuar për të lëshuar fatura.

2. Fiskalizim i faturave nga zyrat e këmbimit valutor

Referuar nenit 4, të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, si dhe nenit 24 “Fiskalizimi i transaksioneve të shkëmbimeve valutore”, të udhëzimit Nr. 16, datë 03.04.2020 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” (më tej “Udhëzimi”), zyrat e këmbimit valutor duhet që të lëshojnë e fiskalizojnë fatura në përputhje me kërkesat e fiskalizimit për çdo transaksion që kryejnë. Në varësi të llojit të transaksionit, afati për zbatimin e këtij detyrimi përcaktohet në kuadrin ligjor në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Çdo ditë pune, para lëshimit të faturës së parë, duhet që të regjistrohet çelja e arkës, pra deklarimi i gjendjes fillestare. Veprimi i çeljes së arkës kryhet vetëm në lekë. Vlerat monetare në fillim të ditës e monedhës së huaj, konvertohet në lekë me kursin e ditës dhe kundrvlera e saj në lekë regjistrohet si gjendje arke në fillim të ditës. Ky konvertim bëhet për çdo monedhë të huaj dhe gjendja e arkës në fillim të ditës raportohet totali i shumës në Lekë dhe monedha të huaja (të konvertuara në Lekë).

Për dokumentimin e transaksioneve të këmbimit valutor, përdoret fatura e thjeshtë e cila përmban elementët e përcaktuar në nenin 11 të Ligjit. Në varësi të mënyrës së funksionimit, fatura e lëshuar mund të përmbajë komisionin që zyra e këmbimit valutor përfiton nga transaksioni. Faturat për këmbimet valutore nuk do të regjistrohen në librin e blerjes në mënyrë automatike në rastet kur blerësi është një tatimpagues.

Në faturë gjithashtu duhet të tregohet veçmas shuma e komisionit nëse aplikohet dhe shuma përfundimtare në lekë duhet të deklarohet pa përqindjen që zyra e këmbimit valutor përfiton. Pra, në thelb, shuma totale në lekë duhet të jetë shuma e saktë e marrë nga klienti ose që i është dhënë klientit për shkëmbimin e valutës së huaj.

3. Faturat “Porosi” dhe “Përmbledhëse” në sektorin e Hoteleri/Turizëm



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Në zbatim të pikës 3, të nenit 8 të Udhëzimit, tatimpaguesit që kryejnë aktivitet në sektorin e shërbimeve (bar, restorant, hotel, agroturizëm, etj.) mund të përdorin faturat Porosi dhe faturat Përmbledhëse.

Faturat e lëshuara më mënyrë pagese “Porosi”, fiskalizohen si fatura individuale. Në momentin që klienti largohet dhe kërkon të kryejë pagesën, lëshohet fatura Përmbledhëse. Fatura përmbledhëse duhet të përmbajë sis referencë NSLF e të gjitha faturave porosi të lëshuara më parë klientit.

Secila faturë, porosi apo përmbledhëse, duhet të lëshohet dhe fiskalizohet. Fatura përmbledhëse e fiskalizuar, do të regjistrohet në librin e shitjeve të tatimpaguesit dhe do të merret në konsideratë për qëllim të llogaritjes së TVSH-së në shitje. Vetëm në këtë moëmënt, faturat porosi të lidhura me faturën përmbledhëse nuk merren më në konsideratë për llogaritje të qarkullimit.

Me porosi të kryer nuk kuptohet porosia nga çdo person, por porosia e kryer për çdo tavolinë. Ndërkohë, nëse klientët nga e njëjta tavolinë kryejnë një porosi të dytë, atëherë me dorëzimin e porosisë lëshohet dhe fatura e dytë, e cila edhe mund të mos printohet.

Në shërbimet e hotelërisë, mund të përdoret fatura porosi në rastet kur klienti qëndron për disa ditë dhe paguan në momentin e largimit. Çdo faturë porosi për shërbime të ndryshme, e lëshuar për klientin përgjatë qëndrimit të tij në hotel, duhet që të përfshihet në faturën përmbledhëse e cila lëshohet në momentin e pagesës.

Faturat porosi nuk ndikojnë në gjendjen e arkës, përse kohë me këtë dokument nuk arkëtohen para. Momenti i arktimit prcaktohet m faturën përmbledhëse.

Shembull:

Një klient rezervon një dhomë në hotel më datë 25 maj dhe largohet nga hoteli më datë 5 qershor. Gjatë kësaj kohe merr shërbime nga restoranti, sauna, SPA etj., shërbime të cilat i ngarkon për ti likuiduar në faturën e hotelit. Për faturat e veçanta të lëshuara për çdo shërbim nga data 25 maj deri në 5 qershor, në datën 5 qershor do të lëshohet një faturë përmbledhëse që do të regjistrohet në librin e shitjeve të muajit qershor, e cila do të merret në konsideratë për llogaritjen e TVSH-së në shitje për muajin qershor (moment në të cilin shërbimi është kryer dhe është lëshuar fatura përmbledhëse).



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Fatura përmbledhëse e shërbimeve të hotelit, përmban shumën totale të llogaritur për të gjitha faturat e veçanta që janë lëshuar për çdo shërbim të kryer prej hotelit deri në momentin e largimit të klientit, prej hotelit. Është e rëndësishme që fatura përmbledhëse të referojë të gjitha faturat e veçanta të lëshuara klientit.

Nëse për shërbimet e veçanta që klienti ka marrë gjatë qëndrimit në hotel, klienti ka likuiduar faturën në momentin e kryerjes së shërbimit dhe nuk ia ka ngarkuar faturës së qëndrimit në hotel, për shembull ka marrë shërbimin e restorantit në 30 maj dhe e ka likuiduar faturën e fiskalizuar, atëherë kjo faturë do të regjistrohet në librin e shitjeve të muajit maj, muaj në të cilin është lëshuar fatura. Këto shërbime nuk përfshihen në faturën përmbledhëse që i lëshohet klientit në momentin e kryerjes së shërbimit të hotelit në datën 5 qershor kur ai largohet nga hoteli.

4. Vetëfaturimi për furnizimet nga fermerët

Referuar Udhëzimit Nr. 19, datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, blerësi i produkteve të fermerit, për çdo furnizim të produkteve bujqësore, të marrë prej fermerit, lëshon një faturë tatimore përcaktuar në kuadrin ligjor tatimor në fuqi.

Fatura në këto raste quhet “Autofaturë”, pra kur blerësi lëshon faturën në vend të shitësit. Grumbulluesi i produkteve bujqësore, për çdo furnizim të blerë nga fermeri duhet që të lëshojë dhe fiskalizojë një “Autofaturë” ku në të cilën fermeri duhet të paraqitet si shitës dhe grumbulluesi duhet të paraqitet si blerës. Në varësi të rastit, kjo “autofaturë” mund të jetë me mënyrë pagese me ose pa para në dorë. Grumbulluesi, person i tatueshëm i regjistruar, e lëshon dhe fiskalizon autofaturën nëpërmjet zgjidhjes software që përdor për veten e tij.

Procesi i vetëfaturimit zbatohet nga grumbulluesi si në blerjet nga fermerët e regjistruar ashtu edhe për blerjet nga fermerë të paregjistruar. Në përputhje me dispozitat e Udhëzimit, për blerjet nga fermerët e regjistruar (të pajisur me NIPT), në autofaturë llogaritet TVSH sipas normës tatimore në fuqi për këto transaksione. Për blerjet nga fermerët e paregjistruar (të papajisur me NIPT), në autofaturë nuk llogaritet TVSH.

Autofatura lëshohet për çdo rast në momentin e kryerjes së furnizimit dhe regjistrohet automatikisht në rubrikën përkatëse në librin e blerjeve të grumbulluesit.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

5. Fiskalizimi për Organet Publike

Referuar nenit 4, të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, organet publike qendrore e vendore, të cilat në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar lëshojnë faturë për të dokumentuar transaksionet që kryejnë, duhet të zbatojnë procedurat e fiskalizimit për faturimin duke filluar nga data 1 Janar 2021 duke pranuar vetëm fatura elektronike për furnizimet e mallrave dhe/ose shërbimeve që marrin nga subjektet e tjera tatimpagues.

Për kryerjen e saktë të procedurave të fiskalizimit dhe pranimit të faturave, organet publike qendrore dhe vendore duhet që, përpara datës 1 Janar 2021, të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të aplikojnë pranë ASKHI-t dhe të pajisen me certifikatë elektronike për fiskalizimin;
- Të sigurojnë lidhje të pandërprerë interneti;
- Të sigurojnë pajisjet elektronike të nevojshme (kompjuter, laptop, tablet, etj.)

Çdo organ publik mund të përdorë Portalin SelfCare të ofruar nga Administrata Tatimore, për fiskalizimin e faturave. Përpara fillimit të procedurave të fiskalizimit, organi publik duhet që të japë informacionin e kërkuar, nëpërmjet Portalit SelfCare. Informacioni duhet të jepet mbi njësinë në të cilën kryhet aktiviteti, pajisjes/eve elektronike që përdor, si dhe të personit të autorizuar për të lëshuar fatura.

Pranimi i faturave elektronike në blerje bëhet gjithashtu në portal. Pas aksesimit të portalit, në listën e faturave elektronike në blerje, mund të kontrollohen dhe pranohen faturat e lëshuara për organin publik. Pasi pranohet, fatura elektronike regjistrohet në librin e blerjeve.

Përveç pranimit, në portal tatimpaguesi organ publik mund të japë informacion mbi pagesën e faturës. Pasi zgjidhet fatura për të cilën do të jepet informacion, jepet informacioni për shumën e pagesës, datën e kryerjes së pagesës dhe të dhëna referencë mbi mënyrën e pagesës. Procesi i pagesës së faturave elektronike nga organi publik kryhet nëpërmjet thesarit dhe në çdo rast fatura printohet në letër për të vijuar më tej me veprimet e nevojshme për pagesë.

6. Fiskalizimi i faturave periodike për periudhat e faturimit

Në zbatim të pikës 6, të nenit 8, të Ligjit, fatura periodike është një përjashtim nga rregullat e përgjithshme dhe parashikohet për furnizime të caktuara të mallrave ose shërbimeve, të cilat



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

furnizohen rregullisht ose vazhdimisht, për shembull në industrinë e ndërtimit, për furnizimin me energji elektrike, shërbimin e telekomunikacionit, furnizimin me ujë, shërbime kontabiliteti, qiraja mujore, etj.

Periudha mund të jetë një muaj ose më pak se një muaj (për shembull nëse furnizimi për shërbimet ose mallrat fillon ose përfundon në mes të muajit). Në këtë rast, tatimpaguesi që lëshon faturë duhet të shkruajë detyrimisht në faturë datën e periudhës me të cilën lidhet kjo faturë (në të cilën është bërë shërbimi) dhe data e lëshimit të faturës do të jetë data në të cilën është krijuar dhe lëshuar fatura.

Pavarësisht datës së lëshimit, fatura do të regjistrohet në librin e shitjes dhe librin e blerjes në të njëjtën datë/periudhë si data/periudha e shënuar në faturë, dhe jo në muajin e datës së lëshimit të faturës. Mbështetur në përcaktimet e Ligjit, fatura periodike duhet të lëshohet jo më vonë se dita e muajit që pason muajin në të cilin është kryer furnizimi.

7. Fiskalizimi i faturave në veprimtarinë e transportit urban dhe interurban

Bazuar në nenin 4 të Ligjit, tatimpaguesit të cilët ushtrojnë aktivitetet në transportin urban dhe interurban, janë subjekt i fiskalizimit. Pra, kanë detyrimin që të lëshojnë dhe fiskalizojnë fatura për shërbimin e transportit. Ky detyrim zbatohet për transportin urban dhe interurban të çfarëdo lloji, përfshirë edhe taksitë.

Çdo tatimpagues që ofron shërbimin e transportit urban/interurban duhet të disponojë elementët e nevojshëm për të lëshuar dhe fiskalizuar faturat e lëshura. Përveç, transportit publik urban, në çdo rast tjetër fatura për shërbimin e transportit duhet të lëshohet në kohë reale. Pra, në transportin interurban të çfarëdo lloji dhe transportin me anë të taksive.

Në zbatim të pikës 1 dhe 3, të nenit 5, të Udhëzimit, tatimpaguesit që shesin bileta ose abone për transport pasagjerësh në sektorin e transportit publik urban brenda qytetit (autobusë) në përputhje me vendimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, biletat e shitura gjatë ditës duhet t'i përmbledhin si shumë totale në një faturë të vetme. Në faturë duhet të jepet informacion edhe për numrat serial të biletave të shitura gjatë ditës. Kjo përmbledhëse e fiskalizuar, duhet të lëshohet jo më vonë se fundi i ditës tjetër.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

8. Fiskalizimi i faturave me mënyrë pagese “Tollon” dhe “Kartat e kompanisë”

Pagesat me Tollon

Tatimpaguesit që furnizojnë ose rishesin tollonë me një qëllim përdorimi (p.sh tollonat për furnizimin me karburant), duhet të lëshojnë faturat dhe t'i fiskalizojnë kur lëshohet tolloni. Përshkrimi i mallrave të furnizuar në këto raste duhet të jetë "tollon me një qëllim për 'emrin dhe sasinë e mallrave ose shërbimeve' me numrin serial xxx". Numri serial i tollonit do të jetë NIPT-i i lëshuesit, viti i lëshimit dhe numri rendor i tollonave të lëshuar gjatë atij viti.

Është shumë e rëndësishme që kjo faturë që dokumenton shitjen e tollonit të lëshohet dhe fiskalizohet e para. Më tej, kur zotëruesi i tollonit, e përdor atë si mjet pagese për blerje tek tatimpaguesi lëshues, lëshohet fatura në të cilën pasqyrohet produkti/shërbimi i shitur. Fatura e lëshuar përmban si mënyrë pagese “Tollon”. Kjo faturë, e cila përmban numrin serial të tollonit të përdorur, nuk do të regjistrohet në librin e shitjeve përse kohë është lëshuar dhe fiskalizuar fatura e parë me të cilën u tregtuan fillimisht tollonat.

Në rastin kur vlera e mallrave të furnizuara është më e madhe se vlera e tollonit, atëherë çdo pagesë shtesë nga klienti përfundimtar mbi vlerën e tollonit do të deklarohet në të njëjtën faturë të lëshuar për furnizimin, pra shitësi nuk do të duhet të lëshojë një faturë tjetër, por thjesht duhet të specifikojë në të njëjtën faturë shumën e saktë të paguar me tollonin dhe me mënyra të tjera pagese. Shuma shtesë e paguar nga konsumatori do të merret në konsideratë për llogaritjen e tatimit.

Kartat e kompanisë

Kur furnizimi i mallrave paguhet me kartën e kompanisë të tatimpaguesit, të lëshuar nga tatimpaguesi që furnizon mallrat, shitësi lëshon dhe fiskalizon faturën dhe informacioni identifikues i blerësit duhet të vendoset në faturë (NIPT-i, emri/emri dhe mbiemri).

Fatura përmbledhëse duhet të lëshohet blerësit deri në datën e fundit të muajit, bazuar në faturat e veçanta të furnizimit (për të cilat duhet të referohet NSLF e faturave të veçanta) gjatë muajit. Në këto kushte vetëm fatura përmbledhëse do të merret në konsideratë për llogaritjen e qarkullimit dhe detyrimeve tatimore. Të gjitha faturat (për çdo furnizim dhe fatura përmbledhëse) duhet të fiskalizohen në momentin e lëshimit.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

2.3 *Fatura e lëshuar nga personat rezidentë për marrjen e shërbimit nga personat jo rezidentë.*

Në Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 24 “Rregulli i përgjithshëm” përcaktohet se: “Vendi i furnizimit të shërbimit është në Republikën e Shqipërisë nëse marrësi i shërbimit, një person i tatueshëm që sillet si i tillë, ka në Republikën e Shqipërisë:

- a) selinë e veprimtarisë të tij ekonomike ose një vendndodhje të qëndrueshme për të cilën janë kryer shërbimet, ose;
- b) banesën ose rezidencën e zakonshme, në mungesë të një selie të veprimtarisë ekonomike apo të një vendndodhjeje të qëndrueshme”.

Gjithashtu, Udhëzim nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 24 “Rregulli i përgjithshëm” përcakton se: “ Bazuar në nenin 24 pika 1 të ligjit, si rregull i përgjithshëm, vendi i furnizimit të shërbimeve përveç atyre të parashikuara në nenin 25, 26 të ligjit (përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm), është në Shqipëri, kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm që vepron si i tillë dhe ka në Shqipëri, selinë e veprimtarisë së tij ekonomike apo një vendndodhje të qëndrueshme për të cilën janë kryer shërbimet ose në mungesë të tyre, ka banesën ose rezidencën e zakonshme”.

Po në udhëzimin e sipërcituar është dhënë dhe shembulli si me poshtë:

Shembull: Marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm në Shqipëri Shembull 1- A person i tatueshëm i identifikuar për TVSH-në në Francë i kryen një shërbim konsulencë juridike mbi legjislacionin në Francë një personi të tatueshëm B që ka vendndodhjen e qëndrueshme në Shqipëri. Vlera e shërbimit të kryer është 1000 euro.

Bazuar në nenin 24, pika 1 të ligjit vendi i furnizimit të këtij shërbimi është në Shqipëri në vendin ku marrësi B i shërbimit një person i tatueshëm ka vendndodhjen. B për vlerën e shërbimit të marrë sipas faturës lëshon një faturë tatimore në të cilën sillet sikur e ka kryer vetë shërbimin për vete, në mënyrë që të bëjë të mundur të ngarkojë shërbimin e marrë me TVSH- në Shqipëri prej 20 %. Vlera e transaksionit llogaritet e konvertuar në monedhën shqiptare me kursin e ditës kur lëshohet fatura. P.sh. 1000 euro = 140.000 lekë x 20% = 28.000 lekë është vlera e TVSH-së. Kjo faturë regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjes dhe atë të shitjes së personit të tatueshëm. Në faturë duhet të shkruhet “Auto-ngarkesë e TVSH-së- reverse charge.

Dispozitat e sipërcituara përcaktojnë se, vendi i furnizimit është në Republikën e Shqipërisë, nëse marrësi i shërbimit, person i tatueshëm ka selinë e veprimtarisë, banesën ose rezidencën e zakonshme.

Pra, nëse marrësi i shërbimit është person i tatueshëm i vendosur në Republikën e Shqipërisë, do të lëshojë një faturë tatimore sikur e ka kryer për vete shërbimin, në mënyrë që të ngarkojë shërbimin e marrë me TVSH, sipas shembullit të sipërcituar.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Sa më sipër dhe në lidhje me informacionin e kërkuar, nëse keni detyrime tatimore të tjera lidhur me faturat e marra, ju bëjme me dije se, referuar kuadrit ligjor të sipërcituar, duhet që për shërbimin e marrë nga persona jo-rezidentë, të bëni një autofaturë (reversecharge) bazuar në vlerën e faturës së marrë.

Përsa i përket kërkesës nëse faturat e marra nga shoqëria italiane do ju njihen të plota si shpenzime të zbritshme, ju sqarojmë se, Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 20 “Shpenzime të njohura” përcakton se: *“Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuara nga ky ligj”*.

Gjithashtu, neni 21, gërma gj) “Shpenzime të panjohura” përcakton se: *“Për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, nuk njihen shpenzimet si vijon: tatimi mbi të ardhurat personale, akciza, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të zbritshëm”*

Sa më sipër, legjislacionit tatimor njeh si shpenzime të zbritshme ato shpenzime që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje fitimi, pa përfshirë TVSH e ngarkuar dhe paguar.

2.4 Lidhur me bonuset që përfitojnë punonjësit në varësi të natyrës së punës (volum shitje gjatë muajit).

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8 “E ardhura e tatueshme”, gërma a) përcaktohet se të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale.

Në pikën 2.3 të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 (i ndryshuar) në zbatim të dispozitave ligjore citohet: *“Në të ardhura nga pagat përfshihet paga bazë si dhe të gjitha shtesat mbi pagën bazë që kanë karakter të përhershëm si shtesat për vjetërsi, vështirësi, largësi vendbanimi, natyrë të veçantë pune apo shërbimi, si dhe shtesa të tjera page e shpërblimi të bëra me akte të tjera ligjore e nënligjore.*

Termi “shpërblime të tjera” përfshin të gjitha të ardhurat apo shpërblimet që përfitohen nga rezultatet e punës në vendin e punësimit aktual të individit. Në këtë kategori bëjnë pjesë të ardhurat që merr individi në formë shpërblimi nga fondi i veçantë, apo nga fonde të krijuara me akte të ndryshme ligjore apo statutore të shoqërive, si pagë e 13-të, apo pagesa të ndryshme të kësaj natyre



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Pra, të ardhurat në formë shpërblimi apo bonusi me karakter të përhershëm që përfitojnë punëmarrësit në shoqërinë tuaj si rezultat i natyrës së punës (në varësi të shitjeve që kryejnë gjatë muajit), janë të ardhura që do i nënshtrohen dispozitave të pikës 1 të nenit 9 “Tarifat tatimore” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Gjithashtu, në kreun II “Paga për efekt të llogaritjes së kontributeve” të Vendimit Nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, përcaktohet se, paga bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi, ose në kontratën e punës sipas rastit, me kohë ose vëllim pune dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës.

Paga bruto evidentohet në listëpagesën tip, e cila është deklarata për pagesë dhe dokumenti bazë për evidentimin e kontributeve individuale.

Për sa më sipër, bonuset (shpërblimet) e punonjësve, të cilat lidhen me natyrën e punës së punonjësve dhe janë në varësi të shitjeve që ata kryejnë gjatë muajit, do të trajtohen si të ardhura personale nga paga dhe i nënshtrohen dispozitave të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 9 “Tarifat tatimore”, pika 1 si dhe duke qenë pjesë e pagës bruto mujore, për këto të ardhura do të llogaritet edhe kontributi shoqëror dhe shëndetësor sipas përcaktimeve në Vendimin Nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

2.5 Lidhur me Ligjin nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” si dhe udhëzimin nr.2727, datë 04.02.2020 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit”.

Përfitojnë nga dispozitat e ligjit nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” si dhe udhëzimin nr.2727, datë 04.02.2020 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit” janë përcaktuar qartë kushtet dhe procedurat e përfitimit nga ligji i rivlerësimit.

a) Individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, pasuri të lauajtshme në proces regjistrimi duke përfshirë edhe pasuritë e legalizuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Tatimi që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi **është 3 për qind e bazës së tatueshme.**



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

b) Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2019, në zërin aktive afatgjata materiale, pasuri të paluajtshme me vlerë kontabël më të vogël se vlera e tregut, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin e këtyre pasurive të paluajtshme me vlerën e tregut

Personat juridikë, për këtë rivlerësim, **paguajnë 5 për qind të diferencës** ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar, për pasuritë e paluajtshme.

Diferenca ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar, **nuk është objekt amortizimi për qëllime tatimore.**

Theksojmë se, tatimi i paguar nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme për të dy kategoritë do të jetë tatim përfundimtar.

Nuk përfitojnë nga dispozitat e Ligjin nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

- a) Personat fizikë
- b) Personat Juridikë, të cilët kanë të deklaruara në pasqyrat financiare të vitit 2019 sipërfaqe ndërtimi (banesa apo ambjente shërbimi), të cilat janë të destinuara për shitje nga vetë natyra e aktivitetit që ushtron personi juridik.

2.6. Sqaruese lidhur me qiratë financiare

Çdo institucion financiar bankar apo jo-bankar lidhur me mënyrën e zbatimit të TVSH-së për furnizimet që kryen në kuadër të aktivitetit të tij për të cilin është liçensuar nga Banka e Shqipërisë, duhet të ketë parasysh dispozitat e ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lidhur me furnizimin qirasë financiare, nga pikëpamja fiskale ju bëjmë me dije se, furnizimi i qirasë financiare është furnizim i tatueshëm për TVSH-në kur objekti i qirasë financiare është një mall, i cili nëse do të blihej ose do të vihej në dispozicion të qiramarrësit në kushte normale do të ishte i tatueshëm me TVSH, jo i përjashtuar.

Në rastin kur transaksionet kryhen midis individëve dhe institucioneve financiare, nuk aplikohet TVSH-ja në blerjen e tyre për faktin se individi nuk është person i tatueshëm. Bazuar në nenin 2 “Fusha e zbatimit” të ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton se, një

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

transaksion është në fushën e zbatimit të TVSH-së në Republikën e Shqipërisë, nëse është furnizim malli ose furnizim shërbimi, i kryer kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një *person i tatueshëm* që vepron si i tillë, në kuptimin që ligji i jep secilit prej koncepteve përkatësisht furnizim malli, furnizim shërbimi, kundrejt pagesës, vendi i furnizimit, person i tatueshëm. Fatura tatimore e shitjes për qiramarrësin nga institucioni financiar lëshohet pa TVSH.

Në rastin kur nga ana e institucioneve financiare blihet një automjet (autoveturë) nga një person i tatueshëm ju bëjmë me dije se, ligji Nr.92/2014 datë 24.07.2015 “*Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, në nenin 54 “*Të tjera përjashtime nga TVSH-ja*” ka përcaktuar se, trajtohen si furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet e furnizimeve të mallrave, për të cilat TVSH-ja nuk ishte e zbritshme në blerjen ose përdorimin e tyre, në përputhje me nenin 74, të këtij ligji.

Pra, referuar kuadrit ligjor të sipërpërmëndur nëse, nga ana e një institucioni financiar (leasing) blihet një automjet nga një person i tatueshëm, ku qëllimi i veprimtarisë ekonomike nuk është blerja e autoveturave vetëm me qëllim për t’i shitur ato, atëherë transaksioni i blerjes së automjetit nga institucioni financiar do të jetë pa TVSH. Fatura tatimore e shitjes për qiramarrësin nga institucioni financiar lëshohet pa TVSH.

Ndërsa në rastin kur nga ana e një institucioni financiar (leasing) blihet një automjet nga një person i tatueshëm, ku qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e autoveturave vetëm me qëllim për t’i shitur ato, dhe nga kjo e fundit është paguar TVSH-ja pranë autoriteteve doganore në R.SH atëherë, transaksioni i blerjes së automjetit nga institucioni financiar do të jetë furnizim i tatueshëm me TVSH. Fatura tatimore e shitjes për qiramarrësin nga institucioni financiar lëshohet me TVSH.

Për këtë, çdo pagesë e arkëtuar ose vlerë e faturuar nga qiradhënësi për qiramarrësin mbi baza mujore, përtej vlerës së pagesave periodike të qirasë në kuadër të kontratës së qirasë financiare, konsiderohet element i vlerës së tatueshme të pagesave për furnizimin e qirasë financiare dhe si element përbërës i vlerës së tatueshme të furnizimit të qirasë financiare është e tatueshme me TVSH 20%, përveç interesit, bazaur kjo në nenin 17 “Qiraja financiare, rregulla për tu zbatuar” pika 4, të udhëzimit Nr 6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Theksojmë se, nëse nga personi i tatueshëm, ku qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e autoveturave vetëm me qëllim për t’i shitur ato, blen autovetura nga individ në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me aplikimin e TVSH-së, rrjedhimisht dhe institucioni financiar (leasing) nuk aplikon TVSH-në për qiramarrësin.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Lidhur me furnizimin e ndërtesave nga person i tatueshëm për një institucioni finaciar (leasing) ju bëjmë me dije se, bazuar në nenin 53 “Përjashtime për disa veprimtari të tjera” pika “g” të , ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, furnizimi i ndërtesave apo i pjesëve të një ndërtese, si edhe furnizimi i tokës, në të cilën qëndron ndërtesa, përveç furnizimit të procesit të ndërtimit, konsiderohet furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja. Fatura tatimore e shitjes për qiramarrësin (individ) nga institucioni finaciar lëshohet e përjashtuar nga TVSH-ja.

Neni 49 “Shkallët e reduktuara” i ligjit Nr.92/2014, datë 27.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka përcaktuar, shkallët e reduktuara që aplikohen për furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve në RSH.

Referuar nenit të sipërpërmëndur ju bëjmë me dije se, për blerjet e mallrave të realizuara nga institucioni finaciar (leasing) në të cilat është aplikuar shkalla e reduktuar e TVSH-së 6 për qind (psh. importi mjeteve të transportit publik të licencuar të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik), institucioni finaciar gëzon të drejtën që të zbrësë nga TVSH e llogaritur, TVSH-në e paguar në import, bazuar kjo në nenin 69 “Zbritja e TVSH-së” të ligjit Nr.92/2014, datë 27.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenit 53 “Transaksione që mundësojnë zbritjen e TVSH-së” të dhe udhëzimit Nr 6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Në këtë rast, personi i tatueshëm, institucioni finaciar (leasing) i cili kryen veprimtarinë e qirasë financiare, për **çdo pagesë e arkëtuar ose vlerë e faturuar nga qiradhënësi për qiramarrësin mbi baza mujore, përtej vlerës së pagesave periodike të qirasë në kuadër të kontratës së qirasë financiare, konsiderohet element i vlerës së tatueshme të pagesave për furnizimin e qirasë financiare dhe si element përbërës i vlerës së tatueshme të furnizimit të qirasë financiare është e tatueshme me TVSH 6 për qind, përveç interesit, bazuar kjo në nenin 17 “Qiraja financiare, rregulla për tu zbatuar” pika 4, të udhëzimit Nr. 6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.**

2.7. Sqaruese për menaxhimin e fondeve të investime kolektive.

Ligji 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar, është ligji bazë, i cili përcakton rregullat dhe aplikimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH).



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Sipas përcaktimit ligjor të nenit 2 “Fusha e zbatimit”, tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës, brenda territorit të R.SH, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë si edhe të gjitha importet e mallrave në territorin e R.SH.

Bazuar në nenin 53, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja transaksionet financiare të parashikuara dhe të shprehura në mënyrë të qartë dhe shteruese në këto dispozita, pavarësisht nëse këto transaksione kryhen nga një institucion financiar, ose jo. Çdo transaksion tjetër që nuk është i shprehur në nenin 53 të ligjit, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, nuk përjashtohet nga TVSH-ja. Përjashtimi nga TVSH-ja zbatohet kur transaksioni i kryer është njëri nga shërbimet e parashikuara në këtë dispozitë. *Aplikimi i përjashtimit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me natyrën e shërbimit dhe jo me entitetin ose subjektin që ofron shërbimin dhe as personin që merr shërbimin. Identiteti i palëve është i parëndësishëm.*

Lidhur me problematikën e paraqitur nga ana juaj, bazuar në nenin 53 të ligjit, dhe udhëzimit Nr 6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përjashtimi nga TVSH-ja aplikohet për:

1. Dhënia dhe negocimi i kredive, si edhe menaxhimi i kredive nga ana e kredidhënësit.
2. Negocimi ose çdo marrëveshje tjetër në garantimin e kredive ose çdo sigurim tjetër për paratë, si edhe menaxhimi i garancive të kredive nga ana e kredidhënësit
3. Transaksionet, përfshirë negocimin lidhur me veprimet e këmbimit, llogaritë e depozitave, llogaritë rrjedhëse, furnizimin e likuiditeteve nëpërmjet pagesave, transfertave, marrje-dhëniet e borxhit, çeqet dhe instrumentet e tjera të negociueshme, përveç shërbimit të mbledhjes së borxhit.
4. Transaksionet, përfshirë negocimin, **por jo menaxhimin apo ruajtjen, në aksione kuota, pjesë në shoqëri apo shoqata, në obligacione dhe tituj të tjerë, përveç dokumenteve që vendosin titull mbi mallrat dhe të drejtat apo titujt e përcaktuar në nenin 8, të këtij ligji;**
5. Menaxhimi i fondeve të investimeve, në kuptim të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive;

Bazuar në nenin 53 të ligjit, dhe udhëzimit Nr 6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përjashtimi nga TVSH-ja nuk aplikohet për transaksionet e mëposhtme:

1. Shërbimi i mbledhjes së borxhit



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

2. Transaksionet përfshirë negocimin për monedhat dhe kartëmonedhat për koleksion, që do të thotë monedha ari, argjendi apo monedha të tjera metali ose kartëmonedha që nuk përdoren normalisht si mjet ligjor pagese ose monedha që paraqesin interes numizmatik
3. Transaksionet për menaxhimin apo ruajtjen e aksioneve, kuotave, pjesë në shoqëri apo shoqata, në obligacione dhe tituj të tjerë, si dhe titujt mbi mallrat dhe të drejtat apo titujt mbi pasurinë e paluajtshme që përcaktohen në nenin 8 të ligjit;
4. Qiradhënia e kasafortave edhe nëse ky shërbim kryhet nga një bankë.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, bazuar në dispozitat e nenit 72 Nr.9879, datë 21.2.2008 “Për Titujt” pika 6 citojmë:

Operacionet e lidhura me kujdestarinë e titujve janë: *Shërbime të tjera, të lidhura me titujt, si përmbushja e të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga titujt, siç është rënë dakord ndërmjet klientit dhe kujdestarit dhe që nuk bien në kundërshtim me ligjin. Shërbimi i kujdestarisë së titujve rregullohet me një kontratë, sipas së cilës kujdestari merr përsipër të kryejë një apo më shumë nga operacionet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, për llogari të klientit dhe mbi bazën e një komisioni. Operacionet e lidhura me kujdestarinë e titujve kryhen nga banka të autorizuar për kryerjen e kësaj veprimtarie, me vendim të Autoritetit.*

Për kryerjen e veprimtarisë së lidhur me kujdestarinë e titujve, kujdestari organizon njësi të veçanta brenda strukturës së vet. Autoriteti miraton kushtet e kryerjes së transaksioneve, që lidhen me kujdestarinë e titujve, si dhe kontratën-tip të vënies në kujdestari të titujve.

Pra, nisur nga përcaktimet ligjore më sipër dhe në kuptim të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive, ju bëjmë me dije se, lidhur me shërbimin e depozitimit dhe menaxhimit të fondeve të investimeve ky lloj shërbimi është i përjashtuar nga TVSH-ja.

Ndërsa lidhur me mbajtjen apo kujdestarinë (ruajtjen) dhe menaxhimin e aksioneve kuotave, pjesë në shoqëri apo shoqata, në obligacione dhe tituj të tjerë janë furnizime të tatueshme me TVSH.

2.8. Sqaruese lidhur me furnizimin e shërbimeve të kurseve private.

Çdo person i tatueshëm lidhur me mënyrën e zbatimit të TVSH-së për furnizimet që kryen në kuadër të aktivitetit të tij, duhet të ketë parasysh dispozitat e ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Ligji 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar, është ligji bazë, i cili përcakton rregullat dhe aplikimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Bazuar në pikën g, të nenit 51 “Përjashtimi i disa veprimtarive në inters të përgjithëshëm” të Ligjit Nr.92/2014, datë 27.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimit Nr 6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 39 “Përjashtimi nga TVSH për furnizimin e shërbimeve arsimore” është përcaktuar se, përjashtimi zbatohet për furnizimet e mirëfillta të mësimdhënies shkollore, universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit, përfshirë furnizimin e shërbimeve ose të mallrave të lidhura ngushtë me këtë mësimdhënie.

Për zbatimin e përjashtimit, konsiderohen furnizim i shërbimeve të edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, të mësimdhënies shkollore apo universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit, furnizimet e mëposhtme:

- a. *Furnizimi i shërbimit të mësimdhënies për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, nga institucione të arsimit të lartë, universitar dhe pasuniversitar të njohura si të tilla nga autoriteti kompetent shtetëror.*
- b. *Furnizimi i shërbimeve arsimore të mësimdhënies për realizimin e planeve dhe programeve mësimore në nivele të ndryshme shkollore e parashkollore (arsimi bazë; arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe arsimi profesional, arsimi special, kopshtet).*
- c. *Furnizimi i shërbimeve arsimore të mësimdhënies për realizimin e programeve të arsimit profesional dhe rikualifikimit.*
- d. *Furnizimi i shërbimeve arsimore që kryhen nga institucionet arsimore plotësuese jo-publike, ku punohet në drejtim të arsimit të edukimit në lëndë e specialitete të veçanta që kanë të bëjnë me marrjen e njohurive në lëndë të përfshira në programin mësimor (p.sh. kurse të gjuhës së huaj, matematikë, fizikë, kantoje etj), të miratuara nga autoriteti kompetent shtetëror.*

Ligjvënësi ka përcaktuar se, që këto lloj furnizimesh të jenë objekt i përjashtimit përveç se, duhet të jenë shërbime të edukimit dhe mësimdhënies në të gjitha nivelet, shërbimet duhet të jenë të furnizuara nga institucione arsimore të njohura si të tilla, pavarësisht nëse janë shërbime arsimore ose shërbime dhe mallra të lidhura ngushtësisht me to.

Në kuptim të kësaj dispozite përse i përket shërbimeve të mirëfillta të edukimit, mësimdhënies shkollore, universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit, nuk përfshihen shërbimet e ofruara nga institucione që ofrojnë kurse trajnimi, kualifikimi, kurse të tjera speciale ose profesionale, nëpërmjet të cilave nuk merret një formim i vazhdueshëm për pjesëmarrësit, i cili në përfundim të tij të shoqërohet me një diplomë të vlefshme për t'u njohur si profesion (zanat, specializim), por janë shërbime nëpërmjet të cilave pjesëmarrësi



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

merr ose zhvillon më tej njohuritë e tij në një fushë të caktuar të profesionit ose të ndryshme.

Pavarësisht se, këto kurse profesionale kryhen nga institucione të njohura si të tilla nga autoritetet kompetente, shërbimet që ato ofrojnë nuk janë shërbime të përjashtuara sipas nenit 51, pika g) e ligjit.

Janë të përjashtuar nga TVSH-ja, furnizimi i shërbimit të kurseve apo leksioneve të ofruara privatisht nga mësuesit kur ofrojnë shërbime që kanë të bëjnë me mësimdhënien shkollore apo universitare, për lëndë që bëjnë pjesë në këto programe mësimore dhe që ndiqen nga nxënës e student (p.sh. kurse matematike, gjuhë e huaj, fizikë, etj), bazuar kjo në pikën gj) të nenit 51 të ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pra, referuar përcaktimeve ligjore të sipërpërmëndura furnizimi i shërbimit (kurse profesionale) që një kompani do të ofrojë, është furnizim i tatueshëm me TVSH me shkallën tatimore 20%.